

## Marrëveshje për mbrojtjen e të dhënave personale

Në mënyrë që të llogariten *Benefits* (përfitimet) sipas Benefit Program, myWorld Albania Sh.p.k., një shoqëri e regjistruar në Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kulla nr. 2, Kati i 5<sup>të</sup> - Zyra A3, 1000 Tiranë, Shqipëri mbledh, përpunon dhe ruan të dhënat personale të Anëtarit, veçanërisht emrin dhe mbiemrin e tij, titullin, gjininë, datën e lindjes, adresën e postës elektronike/email, adresën postare, koordinatat e adresës (gjatësia dhe gjerësia gjeografike), numri-at i/e telefonit, numrin i faksit, ID-në e anëtarit, detajet e llogarisë bankare (Emri i Bankës, IBAN, SWIFT dhe emrin e përfituesit të llogarisë bankare) si dhe informacionet rreth aktiviteteve të blerjeve nga ana e Anëtarëve (data, vendndodhja dhe koha e blerjes, shuma e blerjes, valuta, informacioni i shportës së blerjes, sektori, lloji i blerjes (online, offline, tek kompanitë e vogla dhe të mesme (SME), ose tek Key Account partnerët përmes myWorld Card). Gjatë përpunimit të të dhënave të sipërpërmendura nga myWorld Albania Sh.p.k., një shoqëri e regjistruar në Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kulla nr. 2, Kati i 5<sup>të</sup> - Zyra A3, 1000 Tiranë, Shqipëri si përpunues i të dhënave mund të paraqitet gjithashtu edhe myWorld International AG (Grazbachgasse 87-91, 8010 Graz, Austri) dhe Lyconet Global AG (Thurgauerstrasse 132, 8152 Glattpark (Opfikon), Zvicër).

Anëtari nëpërmjet këtij akti jep pëlqimin e tij – nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë - që myWorld Albania Sh.p.k., një shoqëri e regjistruar në Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kulla nr. 2, Kati i 5<sup>të</sup> - Zyra A3, 1000 Tiranë, Shqipëri mund të përpunojë detajet e të dhënave të tija personale të përmendura më sipër për qëllimin të kontaktimit me të përmes postës ose personalisht nga myWorld Albania Sh.p.k., një shoqëri e regjistruar në Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kulla nr. 2, Kati i 5<sup>të</sup> - Zyra A3, 1000 Tiranë, Shqipëri me telefon ose me anë të njoftimit elektronik ("*push notification*") për t'i bërë reklamë për *Benefit Program* ose për oferta të myWorld dhe Kompanive Partnere.

Në mënyrë që të informohet në lidhje me Kompanitë e reja Partnere, mundësitë e reja të blerjes ose ofertat speciale, Anëtari gjithashtu nëpërmjet këtij akti jep pëlqimin e tij - nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë – që Rekomanduesit<sup>1</sup> të Anëtarit ti ofrohen dhe shfaqën informacionet si në vijim: ID-ja e Anëtarit, emri dhe mbiemri, adresa e email-it dhe numri i telefonit.

Anëtari jep pëlqimin e tij - nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë - që myWorld Albania Sh.p.k., një shoqëri e regjistruar në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Kulla nr. 2, Kati i 5<sup>të</sup> - Zyra A3, 1000 Tiranë, Shqipëri autorizohet t'i paraqesë Rekomanduesit të e tij të drejtpërdrejtë dhe Rekomanduesin të tij (këtu e tutje referuar si Rekomandues indirekt) të dhënat në si në vijim në lidhje me aktivitetet e tij të blerjeve dhe blerjet e realizuara për t'u mundësuar atyre të shohin aktivitetet e tij të blerjeve për qëllime llogaritëse: data e blerjes, koha e blerjes, emri dhe mbiemri, shuma e blerjes dhe valuta. Në vend të emrit të plotë të Anëtarit, Rekomanduesi indirekt do të shohë vetëm emrin e Anëtarit dhe shkronjën e parë të mbiemrit të tij.

Anëtari mund të tërheqë pëlqimin(et) e tij (edhe veçmas) me shkrim ose me email në [service.al@myworld.com](mailto:service.al@myworld.com) në çdo kohë me efekt të ardhshëm. Pëlqimi i dhënë në këtë akt për përpunimin e të dhënave personale është i vlefshëm deri kur Anëtari ka tëhequr këtë pëlqim. Nëpërmjet këtyre të dhënave të kontaktit, Anëtari gjithashtu mund të ushtrojë të drejtën e tij për të kërkuar informacion, kryer ndryshime, fshirje, kufizime në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe transparencën e tyre.

<sup>1</sup> Siç është përcaktuar në Kushtet e Përgjithshme të biznesit për anëtarët e myWorld